



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701011/5

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandojmë njohjen e periudhës së tratimit me raport paaftësie në punë 30.09.2009-14.12.2009, si periudhë të vjetërsisë në punë për shtetasin S.H.*

Drejtuar: Z. Astrit CENGU
Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

KUKËS

I nderuar z.CENGU !

Siç jeni në dijeni, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.H, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosmarrje në konsideratë në llogaritjen e pensionit të pleqërisë periudhat 01.01.1994 - 31.03.1995 si dhe 30.09.2009 - 14.12.2009.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi me mbushjen e moshës për pension pleqërie, ka paraqitur dokumentacionin përkatës pranë institucionit që Ju drejtoni.

Ankuesi pretendon se periudha për vitet e punës së bërë në Minierën e Bakrit Gjegjan, Kukës, 01.01.1994-31.03.1995 si dhe periudha 30.09.2009-14.12.2009 gjatë së cilës ankuesi është trajtuar me raport paaftësie të përkohshme në punë, nuk janë marrë në konsideratë në llogaritjen e pensionit të pleqërisë.

Në këto kushte, duke e konsideruar çështjen e tij si shkelje të të drejtave ligjore, ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Për nevojat e shqyrtimit të kësaj ankesë, ju jemi drejtuar për trajtimin e bërë në lidhjen e pensionit të pleqërisë së shtetasit S.H, duke na përcaktuar periudhat që janë marrë në konsideratë në lidhjen e pensionit të tij.

Me shkresën nr.2608/1 datë 12.09.2017, na keni sqaruar për periudhat e njohura në llogaritjen e vjetërsisë së përgjithshme të punës së këtij shtetasi.

Sipas kësaj shkrese periudha 01.01.1994-31.03.1995 dhe 01.10.2009-30.11.2009 nuk i njihet si vjetërsi pune, pasi nuk janë paraqitur vërtetime të pagave.

Nga dokumentacioni bashkangjitur, lidhur me periudhën 01.10.2009-30.11.2009, konstatojmë se me shkresën tuaj nr.1996 datë 21.06.2017, një kopje të së cilës po jua dërgojmë bashkangjitur, ky shtetas është pajisur me një vërtetim, *me anë të cilës vërtetohet fakti se ai është trajtuar me raport paaftësie të përkohshme në punë nga DRSSH-Kukës për periudhën 30.09.2009-14.12.2009. Gjithsej 65 ditë të paguara me 80% të barabartë me vlerën 56368 lekë.*

Në analizë të akteve ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, rezulton se:
-Ligji nr.7703 datë 11.05.1999 "*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në Kreun I, *E ardhura për sëmundje*, ka përcaktuar kushtet e përfitimit, shumën e të ardhurave dhe periudhën e përfitimit.

Në nenin 21, *Kushtet e përfitimit*, thuhet shprehimisht se:

" 1. Personi i siguruar përfiton të ardhurat për sëmundje, kur vërtetohet me raport mjekësor se ai është përkohësisht i paaftë për të punuar dhe kjo paaftësi nuk është pasojë e një aksidenti në punë ose e një sëmundjeje profesionale.."

Neni 2/a i këtij ligji ka përcaktuar se sigurimi shoqëror i detyrueshëm është jofitimprurës që mbron me të ardhura personat e punësuar në lidhje me *..paaftësinë e përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes...etj.*

Në kushtet kur pagesa e këtij përfitimi jepet vetëm për personat e punësuar, të siguruar, atëherë kjo periudhë duhet të merret në konsideratë në llogaritjen e vjetërsisë në punë të shtetasit S.H.

Sa më lart, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se : "*Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*",

REKOMANDOJMË:

Njohjen e periudhës së tratimit me raport paaftësie në punë 30.09.2009-14.12.2009, si periudhë të vjetërsisë në punë për shtetasin S.H.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit "Për Avokatin e Popullit", ku thuhet shprehimisht se: "*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një*

rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit", lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI